



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 952/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc, kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, Lindita Purova nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli A.nr.952/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Lindita Purova nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Lindita Purova nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prizren, me të cilën pretendon se sipas rezultateve të publikuara nga KQZ-ja nuk ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave për tu certifikuar me mandatin në Kuvendin Komunal të Prizrenit. Parashtruesja e apelit thekson se duke u bazuar në përkrahjen dhe premtimet gjate fushatës zgjedhore na ana e qytetarëve dhe numrin e madh të pjesëmarrësve në takime të cilët i kanë premtuar se do ta votojnë duke i përfshirë edhe familjarët e saj si dhe duke u bazuar në numrin e madh të fletëvotimeve të shpallura si të pavlefshme, lind dyshimi i bazuar se ndoshta pa dashur janë bërë gabime të cilat kanë ndikuar në rezultatin e pamjaftueshëm për të fituar mandatin e asambleistës. Andaj e njëjta kërkon që të

rinumërohen vendvotimet si ne vijim: 2006A/01R, 2042A/15R, 2002A/03R, 2001A/02R dhe 2004A/03R.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thënie e saj nuk mbështeten në asnjë provë konkrete, por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Lindita Purova nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Prizren, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.952/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.